

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal si gjykatë e shkallës së parë penale, gjyqtari Adem Shabani, me asistentin Muedin Rexhepi, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.S. nga fshati, komuna e Ferizajt, i akuzuar nga Prokuroria Themelore në Ferizaj sipas aktakuzës PP/II nr.1642-2/14 e dt.26.08.2015, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 nënpar.4 të KPRK-së, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 13.05.2016 në prani të përfaqësuesit të akuzës - prokurorit të shtetit Visar Musa dhe të akuzuarit, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari A.S. nga fshati, Komuna Ferizaj, data e lindjes.... në të njëjtin vend, nga i ati H. dhe e ëma R., e gjinisë S., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën fillore, i martuar, babë i dy fëmijëve, me profesion ndërtimtar, i gjendjes së mesme ekonomike, i pa dënuar deri me tani, mbohet në liri.

Ë S H T Ë F A J T O R Ë

Sepse me datën 02.07.2014 rreth orës 18:30 në Ferizaj, në rrugën “Enver Topalli”, përkatësisht para shtëpisë së të dëmtuarit N.B., pas një konflikti verbal lidhur me një themel i cili kishte filluar të betonohet, pasi që i dëmtuari e kishte kontestuar vendin si dhe pasi që e kishte fyer me fjalë të pandehurin, i pandehuri me një letfë mjetë ky i përshtatshëm për shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor, e kishte goditur në shpinë, nga e cila goditje i dëmtuari pëson lëndime të lehta trupore-ndrydhje në regjionin e shpinës, lëndime këto me pasoja të përkohshme për shëndet.

Me të cilën kreu vepër penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 nënparë 4 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të dispozitës ligjore të sipërtheksuar, si dhe dispozitave ligjore nga neni 7,17,23,41,42,43,45,46,47 dhe 73 të KPRK-së si dhe neneve 361 dhe 365 të KPPK-së të akuzuarin e

G J Y K O N

DENIM ME BURGT në kohëzgjatje prej 1 /një/ muaji i cili dënim konform nenit 47 të KPRK-së, me pëlqimin e të akuzuarit i zëvendësohet në dënim me gjobë në lartësi prej 300 /treqindë euro/, të cilën gjobë obligohet ta paguaj në afat prej 90 ditëve nga dita kur aktgjykimi të merrë formën e prerë.

Nëse dënimin me gjobë nuk paguhet në afatoin e dhënë më lartë, do të ekzekutohet dënimi me burg prej 3 /tre/ muajve.

I dëmtuari N.B. nga Ferizaj, rruga “.....” pn., për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike udhëzohet në kotest civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve penale të paguja shumën prej 20 Euro dhe në emër të paushallit gjyqësorshumën prej 20 Euro, të gjitha këto në afat prej prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcnimin e përmbartimit me dhunë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj ka paraqitur aktakuzën Ferizaj PP/II nr.1642-2/14 e dt.26.08.2015 me të cilën ka ngarkuar të akuzuarin A.S. nga fshati, komuna e Ferizajt, për shkak të veprës penale penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 nënparë 4 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar rreth kësaj çështje penale konform nenit 245 par.1 të KPPK-së me dt.13.05.2016 ka mbajtur shqyrtimin fillestar në të cilin kanë marrë pjesë prokurori i shtetit Visar Musa dhe i akuzuari A.S..

Në shqyrtimin fillestar gjyqtari ka konstatuar se i akuzuari në afatin ligjor me kohë së bashku me ftesën për shqyrtim, ka pranuar edhe një kopje të aktakuzës.

Në fillim të shqyrtimit fillestar i akuzuari është udhëzuar në kuptim të nenit 246.1 të KPPK-së pastaj gjyqtari gjykues ka çmuar se të dërgjtat e të akuzuarit janë rerspektuar, e më pas prokurori i shtetit ka lexuar aktakuzën ndaj të akuzuarit dhe pasi që gjyqtari është bindur se i njëjti e ka kuptuar në tërësi aktakuzën me të cilën është akuzuar, të njëjtit i ka dhënë mundësi të deklarohet mbi fajësinë apo pafajësinë e tij lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet.

I akuzuari A.S. ka theksuar se e ndien veten fajtorë dhe e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar si në dispozitiv të aktakuzës duke theksuar se është e vërtet se atë ditë gjersa ishin duke punuar ka ardhur i dëmtuari ku i ka fyer dhe i pengontete të punonin i akuzuari kishte në dorë një letfë pasi ishte duke punuar e pranon se e ka goditur të dëmtuarin më pastaj me te janë pajtuar dhe ka raporte të mira për lëndimet që i ka shkaktuar pendohet dhe ka premtuar se nuk do të përsërisë veprime të tilla në të ardhmen, i ka propozuar gjykatës që me rastin e shqiptimit të sanksionit penal të marr për bazë theksimet e cekura më lartë.

Gjyqtari në kuptim nenit 248 par.1 nën.par.1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe par.4 të KPPK-së, është e bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajsisë,

pranimin e ka bërë vullnetarisht duke e mbështetur në provat që përmban aktakuza dhe në materialet e prezantuara nga ana e prokurorit të shtetit.

Pas pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit gjyqtari në kuptim të nenit 248 par.2 të KPPK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajësisë.

Prokurori i shtetit Visar Musa ka theksuar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit pasi pranimi i fajësisë është bërë konform ligjit dhe pranimi mbështetet edhe me povat materiale që gjenden në shkresat e kësaj lënde dhe kërkon nga gjykata që të njejtin ta pranoj si të till.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar se i akuzuari pranimin e fajësisë e ka mbështet në provat që gjenden në shkresat e kësaj lënde penale gjegjësisht në mendimin dhe konstatimin e ekspertit mjeko ligjor i datës 21.07.2015 në deklaratën e të pandehurit dhe të dëmtuarit të dt.03.07.2014 dhe vërtetimin mbi konfiskimin e sendeve i datës 01.06.2014, që gjenden në shkresat e kësaj lënde e nga të gjitha këto ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

I akuzuari me datën 02.07.2014 rreth orës 18:30 në Ferizaj, në rrugën “.....”, përkatësisht para shtëpisë së të dëmtuarit N.B., pas një konflikti verbal lidhur me një themel i cili kishte filluar të betonohet, pasi që i dëmtuari e kishte kontestuar vendin si dhe pasi që e kishte fyer me fjalë të pandehurin, i pandehuri me një lehtësi mjetë ky i përshtatshëm për shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor, e kishte goditur në shpinë, nga e cila goditje i dëmtuari pëson lëndime të lehta trupore-ndrydhje në regjionin e shpinës, lëndime këto me pasoja të përkohshme për shëndet.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet e veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 nënparë 4 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK së të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin mori pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ka theksuar se më nuk do të ndërmar veprime të tilla , me çka ka treguar sinqeritet në procedurën penale, gjendjen e tij ekonomike, mbi bazën e këtyre rrethanave gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe rrezikshmerinë konkrete të kësaj veprë penale, dhe në kuptim të të gjitha këtyre, i shqipton dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykmi, duke qenë e bindur se një dënim i tillë është në proporcion dhe raport me peshën e veprës konkrete penale, rrethanave të kryerjes si dhe personalitetin e të akuzuarit dhe me te arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës speciale që i akuzuari të mos kryejë vepra penale si dhe në kuptim të preventivës së përgjithshme të parandalimit të kësaj veprë penale në shoqëri konform nenit 41 të KPRK-së.

Konformë nenit 463 parag.1 lidhur me par 3.të KPPK-së, të dëmtuarin N.B. nga Ferizaj, rruga “.....” p.nr., për realizimin e kërkeses pasuroro-juridike e ka udhëzuar në kontest civil.

Në bazë të nenit 450 të KPPK-së gjykata të akuzuarin e obligoj që të paguaj shpenzimet e procedurës penale për ekspertizën mjeko-ligjore në shumë prej 20 Euro,si dhe të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 20 Euro, të gjitha këtë në afat prej prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcnimn e përmbarimt me dhunë.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
P.nr.1067/2015 datë 13.05.2016

Asistenti
Muedin Rexhepi

Gjyqtari
Adem Shabani

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar
ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit,
Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.